



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 2268141; 2268142

Nr. 580/7 Prot.

Tiranë, më 14.07.2017

**V E N D I M**

Nr.162, datë 14/07/2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 172, datë 30.12.2016, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 674/1 prot., datë 25.11.2016", në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 172, datë 30.12.2016, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 674/1 prot., datë 25.11.2016", në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit,

**Vërej se:**

Bazuar në kërkesën Nr. 674 prot., datë 22.11.2016, të nëpunësit \*\*\*\*\* me detyrë "Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit", pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Komisioneri, me Urdhrin nr. 674/1 prot., datë 25.11.2016, ka nisur verifikimin e kësaj kërkeje. Ky proces është përmblyllur me Vendimin Nr. 172, datë 30.12.2016, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 674/1 prot., datë 25.11.2016", në të cilin, Komisioneri ka vendosur:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në këtë rast, në bashkëpunim me organet disiplinore përkatëse të drejtojnë procesin administrativ për kryerjen e veprimeve si më poshtë:
  - Të anulohet akti administrativ nr. 4430, datë 27.10.2016, i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, për dhënie mase të pezullimit nga detyra, për nëpunësin \*\*\*\*\* dhe të rivendosjen të drejtat e punonjësit për këtë periudhë, duke përfshirë edhe marrëdhënien financiare.
  - Të anulohet vendimi nr. 4547/11, datë 18.11.2016, i Komisionit Disiplinor, dhënie mase "Largim nga shërbimi civil", për nëpunësin \*\*\*\*\*.

- *Të anulohet urdhri nr. 4547/12, datë 21.11.2016, i Drejtorit të Përgjithshëm, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare”, për nëpunësin \*\*\*\*\*, duke e kthyer atë në pozicionin e mëparshëm.*
- 2. *Njësia përgjegjëse, të fshijë shënimet për masën disiplinore “largim nga shërbimi civil”, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*, në dosjen e personale dhe regjistrin e personelit.*
- 3. *Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Njësia e Personelit të Drejtorisë të Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.*
- 4. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative të sipërshënuara, lihet afat, 10 ditë.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 172, datë 30.12.2016, të Komisionerit, me Urdhrin nr. 580 prot., datë 23.05.2017, “Për verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 172, datë 30.12.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të të këtij vendimi.

Për këtë qëllim, u ngrit grupi i punës, me përbërje Stela Ndoka dhe Helga Peti, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 24.05.2017, u paraqitën në insitucion. Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 580/1/1 prot., datë 23.05.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në institucion komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe u konstatua që ky vendim nuk ishte zbatuar. Ky fakt është materializuar në procesverbalin e datës 24.05.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit, i cili u refuzua të firmosej nga personi i kontaktit të institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Në vijim, me shkresën nr. 580/5 prot., datë 26.05.2017, “Kërkesë për informacion”, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Komisioneri ka kërkuar informacion të plotë nëse rasti i këtij nëpunësi është duke u trajtuar nga gjykata. Në përgjigje të kësaj shkrese, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. 5769/1 prot., datë 02.06.2017, “Kthim përgjigje”, ka informuar Komisionerin se kjo çështje është ende në proces gjykimi.

Në këto kushte, referuar nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”, zbatimi i këtij vendimi nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 172, datë 30.12.2016, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 674/1 prot., datë 25.11.2016*”, në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Agjencia Kombëtare e Ushqimit, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**